
BULETIN INFORMATIV

KORRIK 2025

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së
Shkencave të Shqipërisë**

Korrik, 2025

Përmbajtje

Mbledhje të asamblesë	5
Mbledhja e Asamblesë.....	6
Avancim në titullin “Akademik”, prof. Besnik Baraj, prof. Gëzim Hoxha dhe prof. Stefan Çapaliku	6
Zgjidhet anëtar i Asamblesë duke fituar titullin “Akademik” në shkencën e historisë prof. Hamit Kaba	6
Zgjidhet anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë David Kalaj	6
Pranohet anëtar nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë Melissa J. Perry	6
Veprimtari përkujtimore në nderim të Ismail Kadaresë	10
U mbajt veprimtaria “Përkujtimore në nderim të Ismail Kadaresë”	11
Në 1-vjetorin e ndarjes nga jeta të shkrimtarit të madh dhe akademikut Ismail Kadare, Akademia e Shkencave dhe Kuvendi i Shqipërisë organizoi veprimtarinë “Përkujtimore në nderim të Ismail Kadaresë”	16
Aktivitete.....	19
Deklaratë për mediat e Kryetarit të Akademisë së Shkencave akademik Skënder Gjinushi	20
U mbajt takimi shkencor me temën “Gjuhët e Ballkanit në një dimension të ri”	22
U mbajt konferenca shkencore mbarëkombëtare Prurje shkencore në mendimin gjuhësor shqiptar në fushën e semantikës leksikore, gramatikore, diskursive, si dhe në dijen terminologjike.....	25
U mbajt Konferenca e Tretë Ndërkombëtare e Shëndetit Publik dhe Mjedisit	34
Zbulimet në Lin, Shqipëri: Vendbanimi më i vjetër liqenor në Europë	38
Takime	40
Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, priti në një takim miqësor prof. emeritus Brian D. Joseph, bashkautorin e veprës “The Balkan languages”	41

In memoriam.....	43
Përkujtojmë me nderim akademik Aleks Budën në ditën e ndarjes nga jeta.	44
Më 21 korrik 2003 u nda nga jeta akademik Dhimitër Shuteriqi, poet, prozator, studiues dhe publicist i njohur	45

Mbledhje të asamblesë

Mbledhja e Asamblesë

- Akademikët e asociuar Besnik Baraj, Gezim Hoxha e Stefan Çapaliku fitojnë titullin akademik-
- Prof dr. Hamit Kaba zgjidhet anëtar i Asamblesë me titullin akademik-
- Matematikani i njohur shqiptar i Malit të Zi, prof. dr. David Kalaj zgjidhet anëtar i jashtëm i ASHSH-së-
- Prof. Melissa Perry, personalitet i shquar shkencor e nivelit ndërkombëtar në fushën e shëndetit publik zgjidhet anëtare nderi e ASHSH-së-



Më 14 korrik 2025 u mbajt mbledhja e Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nën drejtimin e Kryetarit akad. Skënder Gjinushi; me praninë e Kryesisë dhe të anëtarëve të Asamblesë.

Mbledhja kishte për qëllim zhvillimin e votimit për avancimin në titull të tre akademikëve të asociuar, votimin për një akademik në fushën e historisë, pranimin si anëtar nderi të një personaliteti të shquar në fushën e shkencës dhe zgjedhjen e një anëtari të ri të jashtëm të Akademisë.

Asambleja përmes një votimi ceremonial zgjodhi prof. Melisa Perry si anëtare nderi e Akademisë së Shkencave. Në motivacionin e lexuar nga akad. Gjinushi u nënvizua profili i saj si një nga figurat më të shquara në shkencën e shëndetit publik në nivel global, me kontribute të rëndësishme në epidemiologji, toksikologji mjedisore dhe ndikimeve të ndotjes në shëndetin publik. Me angazhime të vazhdueshme në shkencën shqiptare, ajo ka qenë nismëtare e konferencës së parë mbi infodeminë dhe organizatore

kryesore e Konferencës Ndërkombëtare për Shëndetin Publik dhe Mjedisin në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave.



Prof. dr. David Kalaj një personalitet i shquar në shkencën e matematikës u zgjodh anëtar i jashtëm i ASHSH-së. Ai është autor dhe bashkautor i 125 artikujve shkencorë, prej të cilëve 120 janë botuar në revista të indeksuara, si: Mathematische Annalen, Advances in Mathematics dhe Transactions of the AMS. Sipas Google Scholar-it, puna e tij është cituar rreth 1800 herë. Ai ka bashkëpunuar me matematikanë të njohur ndërkombëtarë dhe ka marrë pjesë në mbi 40 konferenca shkencore. Prof. Kalaj ka përkthyer mbi 10 tekste shkollore nga gjuha malazeze në gjuhën shqipe.



Asambleja vlerësoi punën dhe rezultatet në kërkimin shkencor të tre akademikëve të asociuar, Besnik Baraj, Gëzim Hoxha, Stefan Çapaliku, që pas votimit morën titullin akademik.



Në fushën e historisë Asambleja zgjodhi prof. dr. Hamit Kabën si anëtar të ri të saj.



Në përfundim të mbledhjes Kryetari uroi të zgjedhurit dhe falënderoi anëtarët e Asamblesë për kontributin e tyre.

www.akad.gov.al

Veprimtrari përkujtimore në nderim të Ismail Kadaresë

U mbajt veprimtaria “Përkujtimore në nderim të Ismail Kadaresë”

Në 1-vjetorin e ndarjes nga jeta të shkrimtarit të madh dhe akademikut Ismail Kadare, Akademia e Shkencave dhe Kuvendi i Shqipërisë sot, më 1 korrik 2025, mbajtën veprimtarinë përkujtimore në nderim të tij.

Kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike akad. Gëzim Hoxha, në hapje të veprimtarisë, i uroi mirëseardhjen: Kryetares së Kuvendit, znj. Elisa Spiropali; Kryetarit të Akademisë Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi; ambasadorit të Kosovës në Shqipëri, z. Skënder Durmishi; bashkëshortes së shkrimtarit, zonjës Helena Kadare, si dhe akademikëve e miqve të pranishëm në këtë veprimtari.



Akad. Skënder Gjinushi në fjalën e tij tha se “Humbja fizike e Kadaresë është pa dyshim humbja më e madhe e letërsisë sonë; është një humbje shumë e madhe e kulturës dhe letërsisë europiane e botërore, e akademizmit shqiptar e atij evropian. Vepra e Kadaresë do të ruhet si një nga thesaret e kulturës sonë e të shkencave albanologjike”.

Më tej, Kryetari i ASHSH-së foli për personalitetin e shkrimtarit dhe vendin e rolin që zë vepra e tij në letërsinë shqiptare e atë europiane, në orientimin e identitetit të shqiptarëve dhe lëvrimin e gjuhës shqipe. Ai theksoi se: “Kadareja është një busull e përcaktimit evropian të Shqipërisë, avokati më me influencë i pranimit të Shqipërisë në familjen europiane, i mbështetjes së zgjidhjes së çështjes së Kosovës e pavarësimit të saj. Kontributi i Kadaresë si lëvruer i gjuhës është po aq i çmuar sa ai i Çabejit e plejadës së tij si studiues të saj.”.



Nëpërmjet një letre të dërguar nga kryetari i Akademisë së Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, akad. Mehmet Kraja, Ismail Kadareja vlerësohet si simbol dhe personifikim i ndërgjegjes kolektive. Zëri i Kadaresë, pavarësisht nëse vinte nga vokacioni letrar ose nga diskursi politik, për kosovarët ka qenë zë integruar. Në mbështetje të Kosovës, ai ka krijuar kontekst politik ndërkombëtar.

Për veprën dhe personalitetin e Ismail Kadaresë foli edhe Këshilltari i Parë në Ambasadën e Francës në Shqipëri, z. Samuel Richard. Ai u shpreh për marrëdhëniet e shkrimtarit me Francën, vlerësimet dhe krijimtarinë e tij si një ndër zërat më të veçantë në letërsinë europiane.

Z. Bujar Hudhri, president i shtëpisë botuese “Onufri”, botues i Kadaresë, u shpreh për marrëdhëniet miqësore me shkrimtarin, udhëtimin me veprën e tij dhe kujtimet e çmuara me shkrimtarin e madh, deri në çastet e fundit të jetës.

Z. Pirro Misha, drejtori i Bibliotekës Kombëtare, MEK, foli për vendin që zë vepra e shkrimtarit në historinë e letërsisë, përfaqësimin e saj në letërsinë ballkanike e atë europiane. Ai e vlerësoi Kadarenë si një fenomen letrar për qasjet disidente dhe rolin e tij në emancipimin e letërsisë shqipe e më gjerë.

Akad. Shaban Sinani bëri një interpretim të veprës “Kur sunduesit grinden”, të cilën e cilësoi si një vepër që është krijuar për fatin e shkrimtarit me mision, i cili duhet t’i thotë vetes: Mbaje kryqin! Ndryshe mos hyr në këtë urdhër të lartë”. Ai theksoi se

“Kadareja krijoi një Shqipëri paralele, fisnike, të denjë për familjen europiane që i kishte takuar që nga epoka e Rilindjes.”.



Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë znj. Elisa Spiropali, e cilësoi Kadarenë si simbol të dinjitetit dhe mendimit vetjak, që ndërtoi një univers të thellë letrar dhe një botë mitike, ku shqiptaria gjeti hapësirë të veçantë. Ajo u shpreh se Kadareja ishte një kolos i madh, i cili mbijetoi edhe nga kritikët më të ashpër dhe u shndërrua në “pasaportën e Shqipërisë” në botë. Trashëgimia e tij i përket jo vetëm Shqipërisë, por gjithë njerëzimit. Ky përvjetor është një moment nderimi për jetën dhe veprën e tij të paharrueshme.



Në vijim, akad. asoc. Gëzim Hoxha, kryeredaktor i revistës “Studia Albanica” bëri prezantimin e numrit special 2024, 2, dedikuar Ismail Kadaresë. Ai tha se redaksia ka synuar të shpalosë nderimin solemn për këtë personalitet të madh, që për dekada të tëra frymëzoi një komb të tërë me fjalën, mitin dhe mendimin e tij.

Akad. Hoxha shprehu mirënjohjen e thellë për kontributet e vyera dhe për bashkëpunimin akademik, që e bëri të mundur këtë numër. Ai theksoi se ky është një nder i vogël për një figurë të madhe – por është një nder që do të mbetet, si gur kujtese dhe frymëzimi, në faqet e shkencës sonë shqiptare.

Veprimtaria vijoi me poezi të recituara nga vetë Ismail Kadare (regjistrime audio).

Në fund të veprimtarisë përshëndeti bashkëshortja e shkrimtarit Helena Kadare, e cila shprehu mirënjohjen për organizatorët, Akademinë e Shkencave e Kuvendin e Shqipërisë, dhe me këtë rast kujtoi disa nga cilësitë dhe vlerat e veprave të shkrimtarit.

“Kur bëhet fjalë për figurën e Ismail Kadaresë jam e ndjeshme ndaj tonit elitare të folësve dhe vlerësimit për veprën e tij. Ishte një shkrimtar shqiptar që ngrii metaforën e tij letrare në nivelin e frymëmarrjes kombëtare, që përshkroi me veprën e tij fatin e Shqipërisë dhe shqiptarëve në tërë rrjedhën e saj. Ashtu si mbijetuan shqiptarët, mbijetoi edhe vetë Ismaili, jeta e të cilit ishte në thelb jeta e shqiptarëve që kërkuan liri, barazi dhe progres...”, tha ndër të tjera, shkrimtarja Helena Kadare.



1. Bashkëlidhur fjala e Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi:

<https://akad.gov.al/ne-1-vjetorin-e-ndarjes-nga-jeta-te.../>

2. Pasqyrimi i veprimtarisë në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë:
<https://www.facebook.com/100068304113048/posts/1062783159341811/?mibextid=wwXIfr&rdid=YkYWJzNwkZChNtnB#>

3. Pasqyrimi i veprimtarisë në media:

<https://www.youtube.com/watch?v=bQFLH815gO4>

https://www.youtube.com/watch?v=O2OXkOdc_r_s

<https://www.facebook.com/reel/621886764260569>

<https://shqiptarja.com/.../nderime-per-kadarene-ne...>

<https://shqiptarja.com/.../nje-vit-nga-ndarja-nga-jeta-e...>

<https://shqiptarja.com/.../nje-vit-pa-ismail-kadarene...>

<https://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=698292>

<https://www.youtube.com/watch?v=igp0ICg8VY4>

<https://rtsh.al/nje-vit-pa-kolosin-e-letrave-shqipe.../>

www.akad.gov.al

Në 1-vjetorin e ndarjes nga jeta të shkrimtarit të madh dhe akademikut Ismail Kadare, Akademia e Shkencave dhe Kuvendi i Shqipërisë organizoi veprimtarinë “Përkujtimore në nderim të Ismail Kadaresë”

Akad. Skënder Gjinushi: Vepra e Kadaresë do të ruhet si një nga thesaret e kulturës sonë e të shkencave albanologjike

-Akad. Gjinushi: Kadareja ishte një busull e përcaktimit europian të Shqipërisë, avokati më me influencë i pranimit të Shqipërisë në familjen europiane, i mbështetjes së zgjidhjes së çështjes së Kosovës e pavarësimit të saj.

Fjala e plotë:

E dashur znj. Helena Kadare

Të nderuar familjarë të shkrimtarit Ismail Kadare

E nderuar kryetare e Kuvendit, znj. Elisa Spiropali

Të nderuar akademikë dhe miq

Si sot, një vit më parë, i dhamë lamtumirën në emër të Asamblesë së Akademisë së Shkencave, të tërë botës akademike shqiptare, anëtarit të saj të nderuar për 35vjet me radhë, gjeniut të letrave shqipe, Ismail Kadare; kryeakademikut, për nga vlera e jehona e veprës së tij, e mirënjohur e vlerësuar ndërkombëtarisht.



Humbja fizike e Kadaresë është pa dyshim humbja më e madhe e letërsisë sonë; është një humbje shumë e madhe e kulturës dhe letërsisë europiane e botërore, e akademizmit shqiptar e atij evropian.

Vepra e Kadaresë i ka kaluar me kohë kufijtë e Shqipërisë e të botës shqiptare, dhe bën pjesë në patrimuanin e letërsisë botërore.

Kadareja do të lexohet e vlerësohet në vazhdimësi, pasi mesazhet e veprës së tij, stili e forca e fjalës dhe mendimit e bëjnë veprën e tij aktuale, tërheqëse dhe emancipuese për të gjitha kohërat.

Kadareja shkroi nën diktaturë, por vepra e tij përkthehet, lexohet e vlerësohet njëllë nga lexuesit në të gjithë botën, pavarësisht cilës kulturë apo cilit sistem politik i përkasin. Ajo vazhdon të vlerësohet me çmimet më të larta, duke fituar garën edhe me homologët e tij, me letërsinë dhe veprat e shkruara në demokraci; duke treguar se vlera e krijimtarisë letrare çmohet me sa ajo nxit emancipimin e shoqërisë, lirinë e lexuesit, e jo nga sa ka kushtëzuar lirinë fizike të shkrimtarit; çmohet kur ajo e bën mendjen e lirë të shkrimtarit pjesë të zgjimit të madh të popujve që rrëzuan “perden e hekurt”, si do ta çmonte Presidenti i Francës kontributin e Kadaresë.



Fjalën e fundit e thotë lexuesi, dhe lexuesit e Kadaresë, të shtrirë tashmë në tërë botën e në të gjitha gjuhët, vijnë vetëm duke u shtuar; dhe e tillë do të jetë vepra e Kadaresë për dhjetëvjeçarë me radhë, krahas veprave të pavdekshme të letërsisë

botërore, që nuk njohin epokë, por bëjnë epokë.

Ne do t'i jemi gjithnjë mirënjohës për gjithçka i la trashëgim popullit shqiptar me krijimtarinë e tij, por veçanërisht edhe për kontributin e dimensionin e tij si akademik.

Kadareja është hulumtuesi, zhvilluesi e mbrojtësi më i zjarrtë e më me influencë i gjuhës shqipe, i origjinës e lashtësisë së saj, i vlerave e pasurisë së saj. Gjuha shqipe, si një gjuhë që arriti të shfaqë talentin e gjenialitetin e Kadaresë në tërë larmishmërinë e thellësinë e tyre, renditet tashmë në gjuhët e mëdha të një populli të vogël. Kontributi i tij si lëvruar i gjuhës është po aq i çmuar sa ai i Çabejt e i plejadës së tij, si studiues të saj.

Kadareja që korifeu i përkatësisë europiane të popullit shqiptar, të vlerave e karakteristikave të kulturës së tij ndër shekuj, të origjinës e lashtësisë së tij ilire e parailire, të zgjedhjes së tij perëndimore që në periudhën e mesjetës. Kadareja ishte një busull e përcaktimit europian të Shqipërisë, avokati më me influencë i pranimit të Shqipërisë në familjen europiane, i mbështetjes së zgjidhjes së çështjes së Kosovës e pavarësimit të saj.

Kadareja është tashmë një figurë identitare e popullit shqiptar, krahas figurave të tilla si Skënderbeu, Ismail Qemali, Nënë Tereza, e si i tillë do të zërë vend në enciklopedinë shqiptare e kujtesën e popullit shqiptar, kudo që ndodhet. Akademia e Shkencave ka pasur privilegjin ta kishte anëtar të saj për 35 vjet me radhë, çka çdo anëtar i saj e quan një nder të veçantë dhe i është mirënjohës për mbështetjen e peshën që i ka dhënë Akademisë e botës akademike shqiptare në tërësi. Emri i Kadaresë i jep një shkëlqim të veçantë Librit të Artë të Albanologjisë të Akademisë së Shkencave, të cilin ai vetë e cilësonte si: “amza e më të shquarve në studimet shqiptare, që prej themelimit të saj deri më sot...kodiku i nderit i atyre që e kthyen shkencën për shqiptarët nga ekzotike në paradigmë, pa të cilën nuk bëjnë dot studimet ballkanistike, europiane dhe indoeuropiane”. Cilësime, të cilave vepra e emri i Kadarese u jep edhe më kuptim.

Ne sot kujtojmë me hidhërim këtë humbje të madhe, për largimin nga jeta të anëtarit të kolegut tonë, për humbjen e ikonës së inteligjencës e kulturës shqiptare, por dhe me krenari e mirënjohje për veprën e Kadaresë, vepër e cila do të ruhet si një nga thesaret e kulturës sonë e të shkencave albanologjike, do t'u përcillet brezave si një testament qytetërimi e identiteti, si një pasuri e vyer kombëtare.

Aktivitete

Deklaratë për mediat e Kryetarit të Akademisë së Shkencave akademik Skënder Gjinushi

Siç dihet, Akademia e Shkencave, pas kryerjes së fazës së parë të reformës që kishte për objekt vetëreformimin e saj e të strukturave pranë saj, është angazhuar në fazën e dytë të reformës, e cila synon reformimin e sistemit të kërkimit shkencor në vend nëpërmjet forcimit e zgjerimit të njësive ekzistuese kërkimore dhe krijimit të atyre të reja në fushat kryesore të dijes.

Reformimi i sistemit të kërkimit shkencor te ne është domosdoshmëri për shkak të prapambetjes që ka ai në krahasim me Europën, e madje edhe me vendet e rajonit.

Anëtarësimi ynë në BE, procesi i Berlinit, strategjia e kërkimit shkencor për 2023-2030-n e vetë ligji i ri për shkencën e rrisin presionin për të pasur një ecuri të mirëmunduar e të koordinuar në këtë drejtim, me synimin konkret që investimi e financimi për shkencën të arrijë së paku në mbi 1% të GDP-së.

Akademia e Shkencave kontribuoi aktivisht në hartimin e ligjit për shkencën, duke e parë atë si një bazë të mirë për t'i dhënë një impuls të ri kërkimit shkencor e shkencës në tërësi, nëpërmjet një sistemi që ngrihet e funksionon sipas standardeve e parimeve të kohës. Po me atë përgjegjësi e interes po ndjekim e vlerësojmë se hartimi i akteve nënligjore, në zbatim të tij, duhet të jenë në përputhje me ligjin e frymën e tij, duke rritur efektshmërinë e qartësinë e veprimit të ligjit e jo duke e deformuar e keqinterpretuar atë.

Me këto akte është mundësia që t'u jepet zgjidhje disa prej problemeve kryesore që lidhen me kërkimin shkencor në Shqipëri, siç janë: statusi e kategorizimi i punonjësve kërkimorë- shkencorë, respektimi i kodit etik në kërkim e lufta ndaj plagjiaturës; standardizimi e rankimi i instituteve e vetë kërkuesve shkencorë; financimi i kërkimit shkencor, ligjërimi i bashkëpunimit institute-shkolla të larta në projekte të përbashkëta, e veçanërisht në realizimin e programeve të doktoraturës etj.

Projektaktet, deri më tani, nuk i plotësojnë pritshmëritë. Ato s'duhet të jenë produkt i strukturave të dominuara nga administrata burokratike, i veprimeve të nxituara dhe, mbi të gjitha, ato duhet të tejkalojnë frymën e mosbesimit ndërinstitutional që shoqëroi ligjin për shkencën.

Me të drejtë, Kryeministri shprehu nevojën e rishikimit të ligjit për arsimin e lartë, i cili duhet të jetë në harmoni me atë të shkencës.

Ligji për shkencën, ai për arsimin e lartë e ai për Akademinë e Shkencave nuk janë ligje konkurruese, por duhet të jenë komplementare e duhen trajtuar si të tillë. Sistemi i kërkimit shkencor e sistemi i shkollave të larta nuk janë të ndarë, por të ndërthurur e nuk mund të zhvillohen pa njëri-tjetrin; çdo forcim i njërit ndikon vetëm

pozitivisht te tjetri.

Detyra e ambicia jonë kryesore e shkencës e arsimit, njehsimi i diplomave të shkollave tona me ato të shkollave të huaja e zbatimi i arritjeve e teknologjive të reja në ekonomi e kudo me ritmet e kohës kërkojnë e realizohen nëpërmjet njehsimit të nivelit shkencor të pedagogëve tanë me ato të homologëve, gjë që arrihet vetëm nëpërmjet përfshirjes së tyre në kërkim.

Akademia e Shkencave, si një institucion i rëndësishë së veçantë në kërkimin shkencor, e koncepton çdo zhvillim të sajin në bashkëpunim me shkollat e larta; çdo strukturë e Akademisë së Shkencave përbëhet edhe nga personeli akademik i IAL-ve; çdo projekt i iniciuar, financuar a mbështetur nga ASH-ja ndërmerret në bashkëpunim e me pjesëmarrjen e specialistëve të IAL-ve. Shembujt më të qartë janë tri projektet madhore të albanologjisë. Dhe kjo nuk është një përvojë a praktikë shqiptare. Kudo, fuqizimi i sistemit të kërkimit, i peshës e rolit aktiv të Akademive ndikon drejtpërdrejt në fuqizimin e sistemit të arsimit të lartë.

Këto, fatkeqësisht, nuk kuptohen nga kushdo, çka çoi në shtimin e disa kufizimeve ambigue a të panevojshme në ligjin e ri për shkencën, të cilat kanë tendencën të thellohen me hartimin e projektvendimeve në proces, e këto përbëjnë shqetësimin tonë.

Për këto arsye: nuk po i jepet një zgjidhje e duhur, por vetëm formale, për etikën e plagjiaturës në kërkim; kategorizimi i kërkuesve shkencorë zhvleftësohet e nuk jep efektin për të cilin është parashikuar në ligj; cenohet autonomia ose krijohen shtigje keqinterpretimi për shkeljen e saj në financimin e institucioneve e të instituteve kërkimore; komprometohet nevoja e bashkëpunimit midis instituteve dhe IAL-ve, duke e kthyer këtë bashkëpunim nga një domosdoshmëri të ligjshme në atribut të njësive të veçanta.

Vetë koha e parashikuar në ligj, nëntor 2025, për miratimin e akteve nënligjore lejon që ato të jenë produkt i një fryme bashkëpunuese ndërinstitutionale, pa nxitim e imponim në harmoni me ligjin e qëllimin e tij, çka do të mundësohej e institucionalizohej dhe me vënien në funksionim të Këshillit Kombëtar për Shkencën e Kërkimin Shkencor, i cili ngrihet për herë të parë pikërisht për këtë qëllim. Kjo risi e ligjit kërkon që aktet, para miratimit përfundimtar, të marrin mendimin e këtij Këshilli, ku janë të përfaqësuar institucionet kryesore të politikëbërjes, zhvillimit e financimit të kërkimit shkencor.

www.akad.gov.al

U mbajt takimi shkencor me temën “Gjuhët e Ballkanit në një dimension të ri”

Veprimtaria u organizua më 2 korrik 2025 nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, pjesë e Akademisë së Shkencave.

Në takim ishte i ftuar nderi profesor emeritus Brian D. Joseph për të bërë prezantimin e veprës së tij të re “The Balkan Languages” (Gjuhët ballkanike).




Vepra është kontribut i përbashkët i dy autorëve të shquar amerikanë, profesorëve të merituar, Brian D. Joseph dhe Victor A. Friedman, botuar nga Cambridge University Press, 2025.

Drejtuesi i takimit, prof. asoc. Aristotel Spiro, u shpreh se jemi të nderuar ta kemi sot mes nesh prof. emeritus Brian D. Joseph, një studiues që ka formuar disa breza shkencëtarësh, me dije, integritet dhe bujari intelektuale. Ai vlerësoi marrëdhëniet e qëndrueshme të miqësisë intelektuale dhe bashkëpunimin që kanë ndërtuar të dy autorët me komunitetin tonë shkencor ndër vite, të cilët zgjodhën vendin tonë për promovimin e parë të veprës në rang botëror.

Për librin “The Balkan Languages” ai vuri në dukje se është fryt i një bashkëpunimi dhe kërkimi më se tridhjetëvjeçar nga dy prej figurave më të

rëndësishme të gjuhësisë ballkanike, që sjell një qasje të re: Përtej përshkrimeve klasike të “ballkanizmave”, ajo ofron një analizë të thelluar të mekanizmave historikë, shoqërorë dhe dialektorë që kanë ndikuar në formimin e Lidhjes Gjuhësore Ballkanike.



Në këtë kuadër, gjuha shqipe zë një vend qendror jo vetëm si një nga gjuhët më të vjetra të rajonit, por edhe si një nga kontribuueset kryesore në formimin dhe përhapjen e veçorive që quhen sot “ballkanizma” – si për shembull, përdorimi i nyjës së prapme shqese, ndërtimet analitike të kohëve, humbja ose dobësimi i paskajores apo strukturat e pronësisë.

Në veprën e tyre, Victor A. Friedman dhe Brian D. Joseph theksojnë rolin aktiv të shqipes jo vetëm si përfituese, por edhe si burim dhe ndërmjetëse në kontaktin ndërgjuhësor. Libri përçon një qasje të ekuilibruar dhe kritike, me një optikë ndërkombëtare, larg pasioneve lokaliste, e cila u jep zë edhe gjuhëve më pak të përfaqësuara, si gjuha rome ballkanike, turqishtja, torlakishtja apo judezmoja.

Botimi i kësaj vepre është një moment i rëndësishëm për gjuhësinë shqiptare dhe për gjithë fushën e studimeve ballkanike. Ai afirmon rëndësinë e shqipes jo vetëm si objekt studimi, por si kontribuuese aktive në historinë komplekse të kontakteve gjuhësore në Europën Juglindore.

Profesor emeritus Brian D. Joseph shprehu mirënjohjen për kontaktet e vazhdueshme me albanologët shqiptarë e të huaj, të cilët e kanë ndihmuar për hulumtimet akademike dhe kërkimet në terren. Ai foli, gjithashtu, për vendin që zë gjuha shqipe në kontekstin e gjuhëve indoeuropiane dhe në kontekstin ballkanik.



Në fund të takimit u bënë pyetje nga të pranishmit dhe u diskutuan çështjet e trajtuara nga dy gjuhëtarët e shquar amerikanë, si prejardhja e ballkanizmave, marrëdhëniet mes dialekteve dhe standardeve, por edhe roli i gjuhëve të vogla në hartën gjuhësore të kësaj treve.

www.akad.gov.al

U mbajt konferenca shkencore mbarëkombëtare Prurje shkencore në mendimin gjuhësor shqiptar në fushën e semantikës leksikore, gramatikore, diskursive, si dhe në dijen terminologjike

Në datën 3 korrik 2025, në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u mbajt konferenca shkencore mbarëkombëtare Prurje shkencore në mendimin gjuhësor shqiptar në fushën e semantikës leksikore, gramatikore, diskursive, si dhe në dijen terminologjike, e organizuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (ASHSH) në bashkëpunim me Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës dhe pjesëmarrjen e studiuesve nga institucionet tona kërkimore-shkencore, të profesoratit të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri dhe Kosovë, si dhe të doktorantëve pranë këtyre institucioneve.



Kjo konferencë u organizua në vijim të punës që po bëhet në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, në kuadër të projektit trevjeçar Mbi zhvillimet bashkëkohore në fushën e Semantikës gjuhësore – këndvështrime e perspektiva të zhvillimit të dijes në mendimin gjuhësor shqiptar (2024-2026), ndërsa janë zhvilluar tashmë tryeza shkencore Mbi zhvillimet bashkëkohore në fushën e Semantikës gjuhësore – këndvështrime e perspektiva të zhvillimit të dijes në mendimin gjuhësor shqiptar (korrik 2024), dhe disa ligjërata në lidhje me këtë tematikë përgjatë vitit 2024 dhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025.

Kjo konferencë, e organizuar në vitin e dytë të projektit, dëshmoi angazhimin dhe përpjekjet e vijueshme të studiuesve në fushën e gjuhësisë në trajtimin dhe interpretimin e problematikave të dy fushave të rëndësishme në të, të Semantikës dhe

Terminologjisë. Pjesë e trajtesave qenë edhe prurjet e studiuesve tanë në dijen e terminologjisë dhe semantikës leksikore e gramatikore, produktet e shumta të të cilëve kanë përvijuar tashmë një traditë të vyer në mendimin teorik gjuhësor të fushave përkatëse, që meriton vëmendje e vlerësim, si një përvojë që mundëson statusin e lartë për zhvillime të mëtejshme në këtë fushë.

Konferencën e hapi prof. dr. Artur Lama (drejtor i Departamentit të Leksikologjisë, Terminologjisë dhe Gjuhësisë së zbatuar), i cili theksoi rëndësinë e kësaj veprimtarie, si një përpjekje e bashkëpunimit institucional për trajtimin e çështjeve të rëndësishme që lidhen me qasjet e reja teorike në fushën e semantikës, të përqendruara jo vetëm në problematikën që ngërthejnë pikëvështrimet e sotme në semantikën leksikore, por sidomos edhe në semantikën gramatikore, tekstore dhe diskursive. Vetvetishëm në këtë problematikë integrohen edhe qasjet mbi teoritë e zbatuara në fushën e terminologjisë dhe praktikave të hartimit të fjalorëve terminologjikë, fushë në të cilën është grumbulluar një përvojë e vyer, e cila meriton të çohet më tej edhe si kërkesë e nevojave të ngutshme që parashtrohen në zhvillimet e sotme shqiptare në fusha të ndryshme të veprimtarisë shoqërore.



Në emër të kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, përshëndeti akad. Gëzim Hoxha (kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore), i cili në fjalën e tij vlerësoi punën që po bëhet në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë për shqyrtimin dhe trajtimin e dukurive të shqipes, të mbështetur edhe në kahet e reja të mendimit gjuhësor të sotëm, bashkëpunimin e këtij institucioni me institucione të tjera të arsimit të lartë, siç është Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe angazhimin e profesoratit të universiteteve të ndryshme në Shqipëri dhe Kosovë në problematikën që ky institucion po i trajton me përparësi.

Në fjalën e saj të përshëndetjes, prof. dr. Esmeralda Kromidha (dekane e

Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës dhe bashkorganizatore e konferencës) theksoi gatishmërinë e institucionit që ajo drejton për të vijuar bashkëpunimin me Institutin e Gjuhësisë dhe Letërsisë, duke e parë këtë bashkëpunim edhe si pjesë të strategjisë së këtij institucioni për realizimin e projekteve ambicioze që Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka ndërmarrë me institucione të tjera europiane në fushë të risive që vërehen në trajtimin automatik të gjuhëve, të përkthimit, inxhinierisë gjuhësore dhe inteligjencës artificiale.



Më tej, punimet vijuan në seanca paralele, për të trajtuar problemet në dijen terminologjike dhe prurjet e personaliteteve që formësuan një traditë të suksesshme në këtë lëmë të gjuhësisë (18 kumtesa në fushë të terminologjisë, në dy seanca) dhe prurjet shkencore në mendimin gjuhësor shqiptar në fushën e semantikës leksikore, gramatikore, diskursive (15 kumtesa, po ashtu në dy seanca).

Në seancat kushtuar terminologjisë, kumtimet formësuan një mozaik çështjesh që kanë të bëjnë me problemet e qasjet teorike mbi të cilat do mund të zhvillohen shqyrtimet e mëtejshme në këtë fushë studimi, me zbatimin e qasjeve të caktuara në produkte tashmë me vlerë në fushën e terminografisë, me gjerësinë e fushave në të cilat terminografia shqiptare ka lënë gjurmë të dukshme dhe rezultate të vyera, e po ashtu edhe me prurjet e përpjekjet në këtë fushë në plan diakronik, por edhe për kontribute të personaliteteve të spikatur që veprojnë e angazhohen në këtë lëmë të mendimit gjuhësor shqiptar a të praktikave të hartimit të fjalorëve terminologjikë në etapën e tanishme.

U vu theksi në konceptualizimet e marrëdhënieve që vendosen mes fjalës dhe kuptimit, termit e konceptit në përfitim të domethënies në fjalë-termat a në njësi më të zgjeruara, si në togfjalëshat emërorë, si dhe në praktikat e pasqyrit të këtyre marrëdhënieve në fjalorët shpjegues a fjalorët terminologjikë; po ashtu edhe në pasurimin e e strukturave kuptimore të fjalëve me koncepte terminologjike (Agron Duro-Marrëdhëniet fjalë/kuptim dhe term/koncept në kënd-vështrimin e semantikës leksikore; Dhimitër Haxhimihali-Vlerat e zbatimit të teorisë së terminologjisë në përpunimin e terminologjisë së kimisë dhe pasqyrimi në fjalorin përkatës; Hajri Shehu-Togfjalësha emërorë që duhen shpjeguar në një fjalor; Jonida Cungu-Pasurimi i strukturave kuptimore të fjalëve me koncepte terminologjike).



U vlerësua ecuria e përpunimit të teorisë dhe praktikave të përvijuara në terminologjinë në shqipe, përvojë e vyer mbi të cilën mund të mbështeten zhvillimet e sotme në fushë të terminologjisë, duke nxjerrë në pah figura e personalitete kontribuese nga koha në kohë dhe objektivat që duhet të synohen për t'u arritur në etapën e tanishme (Emil Lafi, me një parashtrim të historisë së përvijuar në fushë të terminologjisë e terminografisë-Për një organizim të qëndrueshëm të veprimtarisë në

fushën e terminologjisë së gjuhës shqipe; dhe Valter Memisha për prurjet në terminografinë në shqipe të prof. Agron Duros-Ndihmesa e Agron Duros në terminografinë shpjeguese të shqipes).

U trajtuan probleme të lidhura me terminologjinë të vështruar në plan diakronik, për kontributet në të kaluarën, në vepra a shqyrtime konkrete të natyrës terminologjike dhe në produkte të asaj pune nga autorë të veçantë (Abdurrahim Maxhuni-Rreth leksikut dituror në veprat e Naim Frashërit; Evalda Paci-Rreth disa përveçimeve tipike në vepra të letërsisë së vjetër shqipe; Anisa Kosteri-Zamira Shkreli-Studim leksikor dhe semantik i “Fjalorit të Kuvendit të Arbënit” nga Atë Vinçenc Malaj; Vilma Proko-Përfaqësimi i leksikut të fushave të dijes në “Fjalorin arbërisht-shqip” të Kolë Kamsit).



Një interesim i veçantë ishte treguar nga studiuesit në shqyrtimin e përvojave konkrete në hartimin e fjalorëve terminologjike të fushave të ndryshme në shqipe. Është i motivueshëm ky interesim që nxitet nga vetë natyra e shqyrtimeve në lëmë të terminologjisë, që mbulon fusha të ndryshme të veprimtarisë shoqërore, shkencore, kulturore, teknike, mjekësore, sportive, të mësimdhënies etj., të cilave u është kushtuar një vëmendje e veçantë dhe për të cilat gjuhëtarët shqiptarë, terminologët dhe hartuesit e fjalorëve terminologjikë kanë bashkëpunuar me specialistët e fushave përkatëse, duke përfutur në këtë mënyrë një përvojë që duhet studiuar dhe çuar më tej, pasuruar dhe përshtatur me prurjet e reja qoftë të terminologjisë, qoftë të praktikave të reja të hartimit të fjalorëve terminologjikë në fushat përkatëse (Adriatik Deraj-Vendi i orientalizmave në leksikon libror të shqipes së sotme; Eda Shehu-Shfaqje të dukurive semantike në terminologjinë e së drejtës; Juliana Kume-Marlind Pelushi-Leksiku terminologjik i

lojërave sportive:rasti i ndikimit të anglishtes në gjuhën shqipe; Gani Pllana-Marrëdhëniet e terminologjisë teknike me leksikun e zakonshëm; Sejdi Gashi-Shterminologjizimi i termave në fushën e mjekësisë dhe të jurisprudencës në gjuhën shqipe; Lura Turhani-Koburja-Probleme të përvetësimit të terminologjisë shkencore-teknike në sistemin tonë arsimor; Qëndrim Morina- Vendi i terminologjisë fetare në fjalorët e viteve 1954 dhe 1980).



Në seancat kushtuar problematikës së semantikës spikati prirja e shumë referuesve për të sjellë qasje të reja në trajtimin e dukurive të shqipes, që lidhen me semantikën leksikore, gramatikore e diskursive, duke ngritur njëherazi edhe shqetësimin për harmonizimin e prurjeve prej modeleve të përvijuara në shkollat e ndryshme gjuhësore europiane e më gjerë me veçantitë e dukurive të shqipes; dhe, po ashtu, edhe të terminologjisë së përdorur, pasqyruese e këndvështrimeve jo gjithnjë të njëjta që vijnë prej këtyre modeleve e atyre shkollave gjuhësore (Lindita Sejdiu Rugova-Lendita Gjikoili-Çështje të terminologjisë së semantikës së diskursit dhe të pragmatikës në gjuhë shqipe; Artur Lama-Rreth disa vështrimeve për kuptimin - nga semantika leksikore në atë diskursive; Tomorr Plangarica-Semantika diskursive në shumësinë e shfaqjes së semantikës gjuhësore; Anila Kananaj-Mbi konceptin e desemantizimit: rasti i foljeve aspektore të shqipes).

Ndër problemet në të cilat u përqendrua në mënyrë të veçantë vëmendja ishin ato që u kushtoheshin semantikës gramatikore dhe prurjeve të shumta teorike në këtë fushë në shkollat e ndryshme të gjuhësisë europiane dhe amerikano-veriore, të lidhura

ngushtë me problemet gramatikore, morfologjike, fjalëformuese e sintaksore të shqipes (Albana Deda-Kriteri semantik në disa qasje të reja në nivelin e fjalëformimit; Aurela Basha-Fjala dëftore si akt ilokutiv në gjuhën shqipe).

Po ashtu, si faktorë që bartin e shfaqin dinamikën e gjuhës dhe ndërveprimit të saj me realitetin u panë neologjizmat, ngulitja dhe zgjerimi i sferës së përdorimit të të cilave ka të nevojshëm zhvillimin e vetëdijësimit gjuhësor, shfrytëzimin e veglave bashkëkohore të përpunimit të gjuhës natyrore, që atyre neologjizmave t'u krijohet hapësira e nevojshme në burimet normative leksikografike të shqipes (Adelina Çerpja-Neologjizmat në gjuhën shqipe: ndërmjet kreativitetit gjuhësor dhe planifikimit leksikografik).



Një ndër çështjet që kishte tërhequr vëmendjen e studiuesve ishte edhe problematika që ngërthen në etapën e tanishme emërvënja në shqipe dhe përgjithësisht problematika e emrave të përveçëm në shqipe, ndriçuar nga konceptet e semantikës, përmes të dhënave të sotme që ofron realiteti shqiptar dhe qasjet teorike bashkëkohore, të cilat ndihmojnë në interpretime të natyrës semantike (Aristotel Spiro-Morfopragmatika ideologjike dhe estetike e emërvënies shqiptare në gjysmëshekullin e fundit; Irda Dervishi-Nesimi-Çështje të kuptimësisë kontekstuale të emrave të përveçëm (vështrim i përgjithshëm)).

Spikati gjithashtu synimi i studiuesve për të vënë në dukje prurje të personaliteteve kontribuese në këtë fushë, si shenjë respekti e vlerësimi të punës së tyre kërkimore (Hysnie Haxhillari-Hyska, për ndihmesat e prof. Ludmilla Buxhelit-

Ndihmesa e gjuhëtares L. Buxheli në fushën e semantikës gramatikore: Monografia “Modele të caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe” (2007); dhe Resul Telhaj për prurjet e gjuhëtarit Ruzhdi Stringa në veprën e tij të botuar post mortum-Dimensione semantike të leksikut për Kinën në gjuhën shqipe: aspekte leksikore dhe diskursive sipas Ruzhdi Stringës).

Të lidhura ngushtë me semantikën leksikore, si dhe hapësirat shqyrtuese përtej saj, por të lidhura gjithsesi me të, u panë edhe dukuritë dhe njësitë e niveleve të ndryshme gjuhësore të shqipes të shfaqura në regjistra të ndryshëm ligjërimorë dhe stile të caktuara funksionale, si ai i letërsisë artistike, në vepra konkrete të shkrimtarëve shqiptarë (Lediana Beshaj-Manjola Zaçellari-Aspekte të përdorimit të njësive frazeologjike në ligjërimet të ndryshme në anglishte dhe shqipe; Rezarta Xhaferri-Leksiku karakterizues në veprën e Fatos Kongolit:një analizë semantike).



Interpretimi i stilemave e figurave të stilit në këndvështrimin e semantiks leksikore, përvojat për prurjen e terminologjisë në shqipe, si dhe roli i tropeve të ndryshme, si metafora e metonimia në diskurset e natyrs politike a në ligjërimin në media ishte një tjetër qasje që solli interes, përmes shembujve, analizave e interpretimeve të bëra nga këndvështrimet e sotme të semantikës leksikore e diskursive, si dhe stilistikës (Orjeta Baja-Stilemat figurative në perspektivën e semantikës leksikore dhe terminologjisë (Fjalori terminologjik shpjegues “Figurat e stilit”); Ardita Dylgjeri-Fjalë që djegin: roli i tropeve në përfaqësimin e emergjencës klimatike).

Kumtime të ndryshme nxorën në pah mëtimet serioze të shumë referuesve për t’i vendosur shqyrtimet dhe interpretimet e dukurive të shqipes në fushat përkatëse mbi

baza sa më bashkëkohore teorike e metodologjike, duke dëshmuar, në këtë mënyrë, synimet për zhvillime të mëtejshme të mendimit tonë gjuhësor në këto fusha.

Diskutimet e shumta në fundin e çdonjërës prej seancave për problemet e parashtruara në kumtesa treguan për qasjet kritike të studiuesve në lidhje me modele shqyrtimi të caktuara, përshtatshmërinë ose jo të pikëvështrimeve të tyre me veçantitë e shqipes, nevojën për njëjtësimin e terminologjisë që mbulon koncepte të caktuara dhe vështirësinë në jo pak raste të gjetjes së termave të përshtatshëm në shqipe për koncepte që përfaqësojnë dijet ndërdisiplinare në gjuhësinë e diskursit, gjuhësinë konjitive a kahe të tjera të zhvillimeve në etapën e tanishme.

Në përfundim të veprimtarisë u theksua nevoja për vijimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe për nxitjen e studiuesve për thellim të mëtejshëm në problemet e ngritura dhe diskutuara në këtë veprimtari.

U mbajt Konferenca e Tretë Ndërkombëtare e Shëndetit Publik dhe Mjedisit

Konferenca e Tretë Ndërkombëtare e Shëndetit Publik dhe Mjedisit, e organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në bashkëpunim me Universitetin George Mason (SHBA) dhe Collegium Ramazzini (Itali), u mbajt në datat 30 qershor dhe 1 korrik 2025.

Kjo konferencë është e para në vendin tonë që fokusohet drejtpërdrejt në ndërthurjen e ndikimeve mjedisore dhe sfidave të shëndetit publik, duke shërbyer si një platformë bashkëpunimi ndërdisiplinor dhe ndërkombëtar.

Morën pjesë mbi 70 referues nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Italia dhe SHBA dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore hartuese dhe zbatuese të politikave në sektorë të ndryshëm që lidhen me administrimin e ujërave.

Akad. Genc Sulçebe, drejtues i QKBGJ-së dhe akad. Ilia Mikerezi, kryetar i Komisionit të biologjisë, drejtuan seancën e hapjes së veprimtarisë.



Veprimtarinë e përshëndeti zëvendëskryetari i ASHSH-së, akad. Vasil Tole, në emër të Kryesisë. Ai foli për punën që kanë bërë qendrat dhe komisionet e përhershme të ASHSH-së për të mbështetur e zhvilluar një sërë projektsh që trajtojnë ndotjen mjedisore dhe ndikimin e saj në shëndet.



Akad. Tole theksoi se ASHSH-ja po luan një rol aktiv në koordinimin e projekteve kombëtare të kërkimit shkencor, në bashkëpunim me institucionet përkatëse dhe agjencitë e kërkimit shkencor e të inovacionit, për të garantuar që shkenca të vendoset realisht në shërbim të shoqërisë.

Prof. dr. Mira Rakacolli, zëvendësministria e Shëndetësisë, theksoi se nëpërmjet kësaj veprimtarie krijohen mundësi për të ndarë përvoja, për të ndërtuar ura midis fushave që shpesh funksionojnë paralel, si dhe për të gjetur mënyra të reja për ndërgjegjësimin dhe inkurajimin e qytetarëve, por edhe të vetë vendimmarrësve që mjedisi mos të trajtohet si temë dytësore, por si pjesë e pandashme e shëndetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.



Konferencën e përshëndeti edhe znj. Klodiana Marikaj, specialiste në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Ajo foli për strategjitë dhe politikat e menaxhimit të cilësisë së ajrit dhe masat e marra në përputhje me legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe zbatimin e Axhendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor.

Gjatë zhvillimit të seancave plenare, pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen me rezultatet kërkimore të standardeve ndërkombëtare dhe të ndajnë përvoja mbi sfidat që paraqet monitorimi dhe menaxhimi i rreziqeve mjedisore për shëndetin publik, lidhur me cilësinë e ajrit, shqyrtimin e teknologjive dhe qasjeve për pastrimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura dhe përmirësimin e infrastrukturës sanitare, cilësinë dhe sigurinë ushqimore etj.



Ndër paraqitjet më të spikatura ishin: “Vlerësimi i rrezikut shëndetësor nga djegia e hapur e mbetjeve në Shqipëri” nga prof. asoc. Edlira Baraj; “Studimi mbi ndikimin e ndotjes së ajrit në shfaqjen e artritis reumatoid nga akad. Genc Sulçebe dhe dr. Arbi Pecani; “Ndikimi i pandemisë COVID-19 në nivelin e imunitetit në Shqipëri dhe mësimet për të ardhmen nga akad. Genc Sulçebe; “Ndikimi i pesticideve në fertilitet dhe shëndetin riprodhues nga prof.dr. Melissa Perry.

Konferenca arriti disa objektiva të rëndësishëm: Krijimin e një rrjeti ndërkombëtar bashkëpunimi mes shkencëtarëve të mjedisit e shëndetit publik; Identifikimin e sfidave dhe përparësive kërkimore në rajon në fushën e ndotjes mjedisore dhe shëndetit; Formulimin e rekomandimeve për përfshirjen e të dhënave

shkencore në hartimin e politikave publike, si dhe bashkëpunimin institucional për aplikimin e qasjes "One Health" në Ballkanin Perëndimor.

www.akad.gov.al

Zbulimet në Lin, Shqipëri: Vendbanimi më i vjetër liqenor në Europë

Artikulli dhe intervista e studiuesve të publikuar sot më 17 korrik 2025 në Reuters njoftojnë publikun europian dhe botën mbarë mbi një prej zbulimeve më të rëndësishme arkeologjike në Europë në dekadat e fundit: vendbanimi më i vjetër liqenor i njohur deri më sot, i zbuluar në zonën e fshatit Lin, në brigjet shqiptare të liqenit të Ohrit.



Sipas arkeologut zviceran Hafner, këto vendbanime datojnë ndërmjet 6000 dhe 8000 vjet më parë, duke i bërë ato rreth 500 vjet më të vjetër se vendbanimet e ngjashme të zbuluara në rajonet alpine dhe mesdhetare. Sipas studimit të përbashkët nga arkeologë zviceranë dhe shqiptarë, ky vendbanim është më i vjetër se të gjitha vendbanimet liqenore të njohura më parë në Europën Kontinentale, përfshirë ato në Zvicër dhe Itali.

Studiuesit theksojnë se ky vendbanim përfaqëson një fazë të avancuar të zhvillimit njerëzor në Ballkan, që paraprin përhapjen e mënyrave të organizimit shoqëror dhe bujqësisë në Europën Qendrore dhe Perëndimore. Ekipi ka mbledhur mbi 1000 mostra për analiza me dendrokronologji dhe radiokarbon, që po përpunohen nga

specialistë të ETH Zürich dhe institucionet shqiptare. Sipas prof. Adrian Anastasit, bashkëdrejtues i gërmimeve, vetëm 1% e zonës është eksploruar, duke e bërë këtë një projekt kërkimor me ndikim afatgjatë.

Liqeni i Ohrit, i ndarë mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, konsiderohet si liqeni më i vjetër në Europë, me një moshë mbi një milion vjet – një mjedis që ka ndihmuar ruajtjen e këtij thesari arkeologjik.

Më poshtë gjeni artikullin e plotë të Reuters:

<https://www.reuters.com/.../europes-oldest-lake.../>

www.akad.gov.al

Takime

Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, priti në një takim miqësor prof. emeritus Brian D. Joseph, bashkautorin e veprës "The Balkan languages"

Në takim ishin të pranishëm sekretarja shkencore e ASHSH-së, akad. Anila Hoda; kryetari i Institutit të Gjuhës dhe të Letërsisë, akad. Valter Memishaj; prof. asoc. Aristotel Spiro; shefja e marrëdhënieve me jashtë, prof.asoc. Elda Zotaj.



Takimi u mbajt përpara se vepra "The Balkan languages" të prezantohej në veprimtarinë shkencore të organizuar në ASHSH me temën "Gjuhët e Ballkanit në një dimension të ri".

Fillimisht u zhvillua një bisedë kortezie rreth kontributit shkencor mbi 25-vjeçar të autorëve prof. emeritus Brian D. Joseph dhe prof. emeritus Victor A. Friedman, që kurorëzuan publikimin e librit "The Balkan Languages" (Cambridge University Press, 2025).

Autorët e kësaj vepre janë albanologë të mirënjohur, si dhe anëtarë nderi të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Akad. Gjinushi e falënderoi prof. emeritus Joseph-in për punën e palodhur në

hulumtimet akademike dhe kërkimet në terren me kontribute të vlerësuara botërisht në studimet indoeuropeistike dhe albanologjike, dhe për faktin që autorët zgjodhën Akademinë e Shkencave të Shqipërisë për të bërë përurimin e veprës së tyre më të fundit e më të rëndësishme, ku gjuha shqipe zë një vend qendror.




Prof. emeritus Brian D. Joseph foli për rrugën se si i ishte përkushtuar studimit të shqipes, për rolin e veçantë që ajo luan në studimin e gjuhëve ballkanike, duke falënderuar e shprehur interesin për bashkëpunimin me Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë, pjesë e Akademisë së Shkencave.

www.akad.gov.al

In memoriam

Përkujtojmë me nderim akademik Aleks Budën në ditën e ndarjes nga jeta.




Ai është një ndër personalitetet kryesore të shkencës, themelues e kryetar i parë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Në këtë ditë përkujtimore, Muzeu Historik Kombëtar ka bërë një postim, ku vlerëson punën e palodhur dhe veprën e paçmuar të Aleks Budës.

Lexo linkun:

<https://www.facebook.com/share/1CK8cwQVaB/?mibextid=wwXIfr>

Më 21 korrik 2003 u nda nga jeta akademik Dhimitër Shuteriqi, poet, prozator, studiues dhe publicist i njohur



Krijimtaria e tij shkencore iu kushtua zanafillës së qytetërimit shqiptar, të cilën e bëri të njohur nëpërmjet botimeve monografike dhe historiografike, si “Shkrimet Shqipe 1832-1850” (1965), “Historia e letërsisë shqipe”, apo përmes hulumtimeve dhe studimeve për humanistët shqiptarë, figurat e shquara të Rilindjes, historisë së kulturës kombëtare, folklorit etj.

Dhimitër S. Shuteriqi drejtoi për një kohë të gjatë Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë si kryetar i saj. Ai ishte anëtar i Akademisë së Shkencave që prej themelimit më 1972 dhe një ndër themeluesit e arsimit të lartë shqiptar.

Për më shumë, lexo linkun:

<https://www.facebook.com/share/19U74BGDkZ/?mibextid=wwXIfr>